



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja Nr. 89

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

Prishtinë, më 4 Shkurt 2014, në orën 13:00.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Faton Topalli.

Munguan: Sasha Gjokiq, Flora Brovina, dhe Gëzim Kelmendi.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, kordinatore e Komisionit, Muhamet Bytyçi,zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 29.1.2014;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Sigurimin Shëndetësor, para miratimit në parim;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent, para miratimit në parim;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, para miratimit në parim;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për Shëndetin mendor, para miratimit në parim;
7. Shqyrtimi i Projektligjit për Transplantimin e indeve dhe qelizave;
8. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2 . Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 29.1.2014;

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së datës: 29.1.2014.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Sigurimin Shëndetësor, para miratimit në parim;

Fikrim Damka - Fillimisht t'i kalojmë këto katër projektligjet që janë në rend ditës para miratimit në parim dhe mandej të vazhdojmë apo të fokusohemi në shqyrtimin e projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave, i cili është përfunduar nga grupi punues dhe janë propozuar disa amendamente.

Siç e dini, këtë projektligj e kemi pritur të vjen së bashku me projektligjin për shëndetësi, por ka ardhur një vit me vonesë, mirëpo, është mirë që edhe ky projektligj të përfundojë brenda këtij mandati, pasi që është në të mirë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të gjithë neve. Besoj se gjatë amendamentimit në Komision, të ndryshohet ku është e nevojshme, mirëpo, unë jam për atë që ky projektligj të kalojë në parim, dhe të procedohet për miratim në parim në seancë.

Time Kadriaj - Tha se pajtohem që të kalojë për miratim në parim, kush ka vërejtje apo sugjerime mund ti jep edhe në seancë e mandej gjatë punës në komision mund të punojmë bashkërisht.

Pas diskutimeve, Komisioni miratoi në parim Projektligjin për sigurimin shëndetësor dhe rekomandoi që Projektligji të miratohet në parim në seancë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent, para miratimit në parim;

Fikrim Damka – Tha se edhe këtë projektligj mund ta miratojmë në parim dhe ta procedojmë për seancë,

Nazane Breca- Mund të shkojmë me miratimin në parim, mandej në komision do të punojmë bashkërisht për amendamentim.

Pas diskutimeve, Komisioni miratoi në parim Projektligjin për shërbimin mjekësor emergjent dhe rekomandoi që Projektligji të miratohet në parim në seancë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, para miratimit në parim;

Fikrim Damka – Ta se edhe këtë projektligj e kemi pritur të vije për plotësim dhe ndryshim, sepse kur e kemi monitoruar, kemi kërkuar ndryshimin dhe plotësimin e tij, dhe besoj se do të kryhet shumë shpejt sepse i kemi identifikuar problemet dhe jemi të njoftuar me ndryshimet që duhet të bëhen në këtë projektligj .

Pas diskutimeve, Komisioni miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, dhe rekomandoi që Projektligji të miratohet në parim në seancë

6. Shqyrtimi i Projektligjit për Shëndetin mendor, para miratimit në parim.

Fikrim Damka – Edhe këtë Projektligj si edhe projektligjet e tjera sot ta diskutojmë në parim , dhe ta rekomandojmë për miratim në seancë.

Salihe Mustafa – Tha se e kam lexuar projektligjin dhe mendoj se nuk është i hartuar mirë, mirëpo, ta rekomandojmë për seancë për miratim në parim, e mandej gjatë punës në komision mund ta plotësojmë dhe korrigjojmë.

Pas diskutimeve, Komisioni miratoi në parim Projektligjin për shëndetin mendor dhe rekomandoi që Projektligji të miratohet në parim në seancë

7. Shqyrtimi i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave;

Fikrim Damka - Të vazhdojmë me shqyrtimin e Projektligjit për Transplantimin e indeve dhe qelizave, ku grupi i punës e ka shqyrtuar dhe ka punuar në të një kohë të gjatë dhe jemi pajtuar me amendamentet. Ia kaloj fjalën kryesueses së grupit, deputetes Salihe Mustafi, ti paraqes amendamentet e grupit të punës .

Salihe Mustafi – Tha se kemi punuar gjatë si grup i punës bashkë me ekspertë edhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe sot ne mund ti miratojmë amendamentet e këtij projektligji.

Fillimisht kam një propozim që tek qëllimi i ligjit, përkatësisht te neni 1, paragrafi 3, që thotë: Në kuptim të këtij ligji emrat në gjininë mashkullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë femërore dhe anasjelltas pa diskriminim, propozoj se ky paragraf të kalojë tek neni 3. te Përkufizimet si paragraf 1.45, pasi që nuk mund të jetë si qëllim i ligjit por si përkufizim.

Fikrim Damka - Pyeti se a pajtoheni që të bëhet ky ndryshim, pasi që kemi mundësi ende të bëjmë ndryshime nëse ju e vlerësoni.

Pas diskutimeve , Komisioni vendosi që paragrafi 3, i nenit 1, të kalojë te neni 3 , te përkufizimet si paragraf 1.45.

Salihe Mustafi- Tani po ua paraqes amendamentet e propozuara nga grupi i punës, si vijon:

Amendamenti 1

Në nenin 1, paragrafi 3, kalon të neni 3, pas paragrafit 1.44.

Komisioni miratoi amendamentin një.

Amendamenti 2

Në nenin 3, paragrafi 1.2, në fund të paragrafit fjala ”transplantim” zëvendësohet me fjalën “transplantit”.

Komisioni miratoi amendamentin dy.

Amendamenti 3

Në nenin 3, paragrafët 1.11, dhe 1.13., fjala “njerëzor” zëvendësohet me “në njerëz”.

Komisioni miratoi amendamentin tre.

Amendamenti 4

Në nenin 3, paragrafi 1.12, pas fjalës “qelizave” shtohet fjala “të dhuruesit”.

Komisioni miratoi amendamentin katër.

Amendamenti 5

Në nenin 3, paragrafi 1.14., fshihet fjalia “dhe kërkime shkencore”.

Komisioni miratoi amendamentin e pesë.

Amendamenti 6

Në nenin 3, paragrafi 1.22, fjala “furnizim” zëvendësohet me fjalën “prokurim”.

Komisioni miratoi amendamentin gjashtë.

Amendamenti 7

Në nenin 3, paragrafi 1.23, fjala “substancave trupore”, zëvendësohet me “indeve dhe qelizave”.

Komisioni miratoi amendamentin shtatë.

Amendamenti 8

Në nenin 3, paragrafi 1.26, riformulohet si vijon “**Ministria** nënkupton Ministrinë e Shëndetësisë”.

Komisioni miratoi amendamentin tetë.

Amendamenti 9

Në nenin 3, pas paragrafit 1.26., shtohet paragrafi i ri si vijon:

Institucione shëndetësore për transplantimin e indeve dhe qelizave janë struktura shëndetësore, banka të indeve dhe qelizave, njësi të spitalit apo një trupë tjetër, që merret me aktivitete të procedimit, konservimit, ruajtjes apo distribuimit të indeve dhe qelizave të marrura. Gjithashtu mund të jenë përgjegjës edhe për prokurimin dhe testimin e indeve dhe qelizave.

Komisioni miratoi amendamentin nëntë.

Amendamenti 10

Në nenin 3, paragrafi 1.31, fjalia **“Procedurat operative standarde”** zëvendësohet me **“Procedurat standarde të operimit”**.

Komisioni miratoi amendamentin dhjetë.

Amendamenti 11

Në nenin 3, paragrafi 1.32, pas fjalës “qelizë” shtohet fjala “për transplantim”.

Komisioni miratoi amendamentin njëmbëdhjetë.

Amendamenti 12

Në nenin 3, paragrafi 1.35, fjala “parikthyeshme” zëvendësohet me “pakthyeshme”.

Komisioni miratoi amendamentin dymbëdhjetë.

Amendamenti 13

Në nenin 3, paragrafi 1.42, riformulohet si vijon:

1.42. **Reaksioni serioz i padëshiruar** nënkupton reaksionin e papritur dhe të paqëllimshëm, në dhuruesin apo pranuesin, lidhur me ekspertimin, heqjen, trajtimin, përpunimin, ruajtjen, transportimin, dhe implantimin e indeve dhe qelizave, e cila gjendje mund të çojë në vdekje, gjendje të rrezikshme për jetë, përhapjen e sëmundjeve infektive, paaftësi të përhershme për punë ose sëmundje që shkakton qëndrim të zgjatur në institucion shëndetësor.

Komisioni miratoi amendamentin trembëdhjetë.

Amendamenti 14

Në nenin 3, paragrafi 1.43, para fjalës “dërgon” shtohet fjala “mund të” dhe fjalia “që shkaktohet nga qëndrimi i zgjatur” zëvendësohet me “që shkakton qëndrim të zgjatur”.

Komisioni miratoi amendamentin katërbëdhjetë.

Amendamenti 15

Në nenin 5, paragrafi 2, dhe në tërë tekstin e Projektligjit fjalja “me akt nënligjor nga Ministri” zëvendësohet me “me akt nënligjor nga Ministria e Shëndetësisë”.

Komisioni miratoi amendamentin pesëmbëdhjetë.

Amendamenti 16

Në nenin 5, paragrafi 3, fshihet dhe kalon pas nënparagrafi 1.1., me këtë përmbajtje “Shpenzimet materiale lidhur me transportimin e dhuruesit deri në vendin e dhurimit dhe analizat e kryera”.

Komisioni miratoi amendamentin gjashtëmbëdhjetë.

Amendamenti 17

Në nenin 6, paragrafët 4 dhe 5, pas fjalës “Specialistët mjekësorë” shtohet fjalja “të lëmisë përkatëse”.

Komisioni miratoi amendamentin shtatëmbëdhjetë.

Amendamenti 18

Në nenin 6, paragrafi 6, fjala “furnizimin” zëvendësohet me “prokurimin”.

Komisioni miratoi amendamentin tetëmbëdhjetë.

Amendamenti 19

Në nenin 7, paragrafi 4, në fund të paragrafit shtohet fjalja “që nuk janë në pajtim me udhërrëfyesit adekuat”.

Komisioni miratoi amendamentin nëntëmbëdhjetë.

Amendamenti 20

Në nenin 11, paragrafi 1, fshihet fjala “për koordinimin” dhe në fund të paragrafit shtohet fjalja “dhe që është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji”.

Komisioni miratoi amendamentin njëzet.

Amendamenti 21

Në nenin 13, paragrafi 2, në nenin 16, paragrafi 2, dhe në nenin 17, paragrafi 2, fjala “shquar” zëvendësohet me fjalën “i dëshmuar”.

Komisioni miratoi amendamentin njëzet e një.

Amendamenti 22

Në nenin 13, paragrafi 2, fshihet “me kompetencat e Qendrës” zëvendësohet me “procesin e transplantimit”.

Komisioni miratoi amendamentin njëzet e dy.

Amendamenti 23

Në nenin 14, para paragrafit 1, shtohet paragraf i ri si vijon:

Qendra për Koordinimin e Transplantimeve kryen këto detyra: “dhe paragrafët tjerë vazhdojnë si nënparagrafë” .

Komisioni miratoi amendamentin njëzet e tre.

Amendamenti 24

Në nenin 14, paragrafi 8, fjala “publikun” zëvendësohet me fjalën “palët”.

Komisioni miratoi amendamentin njëzet e katër.

Amendamenti 25

Në nenin 14, paragrafi 13, fjala “Organizon veprimtari për të siguruar, zëvendësohet me “Përcakton parametrat për”.

Komisioni miratoi amendamentin njëzet e pesë.

Amendamenti 26

Në nenin 16, dhe në tërë tekstin e Projektligjit fjala “Komisioni Etik për transplantim”, zëvendësohet me fjalën “Komiteti Etik për transplantim”.

Komisioni miratoi amendamentin njëzet e gjashtë.

Amendamenti 27

Në nenin 16, paragrafin 9, dhe paragrafin 12, fjala “zbatueshmërinë” zëvendësohet me fjalën “zbatimin”.

Komisioni miratoi amendamentin njëzet e shtatë.

Amendamenti 28

Në nenin 16, paragrafi 12, fjala “Bordin Etik të Ministrisë”, “zëvendësohet me “Këshillin etik të Odave”.

Komisioni miratoi amendamentin njëzet e tetë

Amendamenti 29

Në nenin 16, paragrafi 14, fshihet dhe paragrafi 16, kalon para paragrafit 15.

Komisioni miratoi amendamentin njëzet e nëntë.

Amendamenti 30

Titulli i nenit 18, riformulohet si vijon “**Institucionet shëndetësore për transplantimin e indeve dhe qelizave**”

Komisioni miratoi amendamentin tridhjetë.

Amendamenti 31

Në nenin 18, paragrafi 3, riformulohet si vijon: “Veprimtaria nga fusha e transplantimit të indeve dhe qelizave kryhet edhe në institucionet shëndetësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës”.

Komisioni miratoi amendamentin tridhjetë e një.

Amendamenti 32

Në nenin 18, paragrafi 5, në fund të paragrafit shtohet fjalia “dhe ky raport duhet të ketë qasje publike”.

Komisioni miratoi amendamentin tridhjetë e dy.

Amendamenti 33

Në nenin 18, paragrafi 11, fshihet fjala “me vendim”.

Komisioni miratoi amendamentin tridhjetë e tre.

Amendamenti 34

Në nenin 20, paragrafi 1, fshihet fjala “të licencuara”.

Komisioni miratoi amendamentin tridhjetë e katër.

Amendamenti 35

Në nenin 22, paragrafi 2, fshihet „se kur”, zëvendësohet me „nëse”.

Komisioni miratoi amendamentin tridhjetë e pesë.

Amendamenti 36

Në nenin 24, paragrafi 1, pas fjalës “plotësohen”, shtohet fjala “njëri nga” si dhe në paragrafin 1.1., fjala “nuk ka mospëlqim”, zëvendësohet me fjalën “ka pëlqim” dhe në paragrafin 1.2., fjala “nuk ka mospajtim”, zëvendësohet me “ka pëlqim”.

Komisioni miratoi amendamentin tridhjetë e gjashtë.

Amendamenti 37

Në nenin 28, paragrafi 11, para „tri ” shtohet “në afat prej”.

Komisioni miratoi amendamentin tridhjetë e shtatë.

Amendamenti 38

Në nenin 30, fshihet paragrafi 3.

Komisioni miratoi amendamentin tridhjetë e tetë.

Amendamenti 39

Në nenin 39, paragrafin 1 dhe 5, fjala “të transplantimit”, zëvendësohet me “që merren me transplantim duhet të”.

Komisioni miratoi amendamentin tridhjetë e nëntë.

Amendamenti 40

Në nenin 41, paragrafi 2, riformulohet si vijon:

„Lista e kërkesave, që duhet të plotësohen për të eksportuar dhe importuar inde dhe qeliza nga dhe në vendet e tjera, duhet të përfshijë mënyrat dhe kushtet e gjurmimit, regjistrimin e të dhënave të gjurmimit, verifikimin e dhënies së transplanteve, sistemin e deklarimit të efekteve të padëshiruara, si dhe procedurat për verifikimin e standardeve të barasvlershme të cilësisë dhe të sigurisë. Procedura e importit dhe eksportit të indeve dhe qelizave, përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria.

Komisioni miratoi amendamentin dyzet .

Amendamenti 41

Në nenin 41, paragrafi 6, riformulohet si vijon:

Eksporti i indeve dhe qelizave do të bëhet pas përmbushjes së nevojave në vend, me propozim të udhëheqësit të Qendrës dhe me lejen e Ministrit të Shëndetësisë, sipas kushteve të përcaktuara me akt nënligjor.

Komisioni miratoi amendamentin dyzet e një.

Amendamenti 42

Në nenin 41, pas paragrafit 6, shtohet paragrafi i ri si vijon:

Importi i indeve dhe qelizave do të bëhet kur nuk mund të bëhet përmbushja e nevojave me inde dhe qeliza nga brenda vendit, me propozim të udhëheqësit të Qendrës dhe me lejen e Ministrit të Shëndetësisë, sipas kushteve të përcaktuara me akt nënligjor.

Komisioni miratoi amendamentin dyzet e dy.

Amendamenti 43

Në nenin 43, paragrafi 1, fshihet fjalia “është organi inspektues që” dhe ne paragrafin 2, fjalia “do të kryejë” zëvendësohet me “organizon”.

Komisioni miratoi amendamentin dyzet e tre.

Amendamenti 44

Në nenin 43, paragrafi 8.2, fjala “dy vite”, zëvendësohet me “një (1) vit”.

Komisioni miratoi amendamentin dyzet e katër.

Amendamenti 45

Në nenin 44, paragrafi 3, fjala “juridike”, zëvendësohet me “ligjore”.

Komisioni miratoi amendamentin dyzet e pesë.

Amendamenti 46

Në nenin 43, paragrafi 3, riformulohet si vijon:

2. Regjistri nga nënparagrafi 1.1., do të ketë qasje publike për aktivitetet specifike për akreditim, dizajnim, autorizim ose licencim të institucioneve shëndetësore për transplantim të indeve dhe qelizave, dhe nuk do të përmbajë të dhëna personale.

Komisioni miratoi amendamentin dyzet e gjashtë.

Amendamenti 47

Në kreun VIII, të fshihet “**ADMINISTRATIVE DHE EKZEKUTIMI**”

Komisioni miratoi amendamentin dyzet e shtatë

Amendamenti 48

Në nenin 48, paragrafi 5, fjalia „Për kundërvajtje respektivisht në gjykatën me kompetencë të njëjtë”, zëvendësohet me “kompetente”.

Komisioni miratoi amendamentin dyzet e tetë.

Amendamenti 49

Kreu i IX-të , me nenet, 49, 50, 51 dhe 52, fshihen dhe zëvendësohen me një nen si vijon:

Neni 49 Veprat penale

Shkeljet që përbëjnë veprë penale, dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës .

Komisioni miratoi amendamentin dyzet e nëntë.

Amendamenti 50

Në titullin e kreut X-të, fshihet “**KALIMTARE DHE:** dhe para nenit 53, shtohet një nen i ri si vijon:

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ministria e Shëndetësisë, në afat prej gjashtë (6) muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të nxjerrë aktet nënligjore të parapara më këtë ligj.

Komisioni miratoi amendamentin pesëdhjetë.

Pas shqyrtimit dhe miratimit të amendamenteve veç e veç, Komisioni me pesë vota për, dhe një abstenim, miratoi amendamentet në Projektligjin për Transplantimin e indeve dhe qelizave ,dhe i procedoj me tej në katër komisionet e përhershme.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka